



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 27.09.2012
Nr. 0203-992

PËR: Agim Aliu, Kryetar i Komunës së Ferizajt
Xhavit Zariqit, Kryesues i Kuvendit të Komunës Ferizajt

LËNDA: Konfirmimin e ligjshmërisë së Rregullores të Komunës së Ferizajt, Nr.0167
pranuar me datën 19.09.2012

Të nderuar/a

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjin, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Rregullores Nr.0167 të miratuar me datë 10/09/2012 nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt te plote juridik:

- Rregullore për bashkëpunimin e komunës me fshatra, vendbanime dhe zona urbane.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i MAPL,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL-së
Drejtorëve të Departamenteve dhe Zyrave
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana, 27.09.2012
Br. 0203-992

Za: Agim Aliu, Gradonačelnik Opštine Uroševac
Xhavit Zariqit, Predsedavajući Skupštine Opštine Uroševac

Predmet: Potvrda zakonitosti Uredbe Opštine Uroševac , Br.0167
primljeno dana 19.09.2012

Poštoavni-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu br.03/L-040 za Lokalnu samoupravu, Zakonu, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kancelarije Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Uredbe Br.0167 usvojene dana 10/09/2012 od Skupštine Opštine Uroševac, **POTVRDJUJE** zakonitost akta i procenjuje da je isti u skladu sa Zakonom o lokalnoj samoupravi .

Pravni Akt koji proizvodi puni pravni efekat :

- Uredba o saradnji opštine sa selima,naseljima i urbanim zonama.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik Premijera i Ministar MALS,

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Direktprima uprava i kancelarija
Arhivi MALS-a

REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA URKŒEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJT

DATA/DATUM/DATE: 19.9.2012

Nr. Nënshkrimi: 01 Nr. Përkrahje: 123 Nr. Fletë: 18

Ferizaj - UrkŒevac

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
 REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
 Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
 Ministry of Local Government Administration

Data: 19.09.2012
 Datum: 19.09.2012

Njësia organizative	Nr. i Lëndës	Shtojca	Vlera
- III -	0208-992	1	



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA URKŒEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJT



KUVENDI I KOMUNËS
 SKUPŠTINA OPŠTINE
 MUNICIPAL ASSEMBLY

Tel / : 044/501/716
 Adresa D. Kombit pn.

DATA/DATUM/DATE	19.9.2012
NR/BR.	01 nr.73

PËR/ZA/TO	MAPL (Gëzim Sahiti)
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Xhavit Zariqi – Kryesues i Kuvendit
NGA/OD/FROM	Kuvendi i Komunës
LËNDA/PREDMET/SUBJECT	Kërkesë për Çertifikimin e Rregulloreve

Konform nenit 81 pika (a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/ L-40 të datës 20 Shkurt 2008 u depozitojmë Rregulloren për Bashkëpunimin e Komunës me Fshatrat, Vendbanimet dhe Zonat Urbane dhe Rregulloren për Ndarjen e Subvencioneve. Këto Rregullore janë miratuar në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Ferizajt, të mbajtur me datën 10.9.2012 dhe kërkojmë që të bëni çertifikimin e tyre.

Kësaj kërkesë ia bashkangjesim Vendimet dhe Rregulloret e miratuara nga Kuvendi i Komunës së Ferizajt.

Me Respekt




Kryesuesi i Kuvendit
 Xhavit Zariqi



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



RREGULLORE
PËR BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRA, VENDBANIMET
DHE ZONAT URBANE



FERIZAJ,
GUSHT 2012

Mbështetur në nenin 4 alineja 4.6 dhe nenit 34 alineja 34.4 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nr. 03/L-040, Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për marrëveshjet e bashkëpunimit të komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, nr. 2008/08 dhe nenit 27 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Ferizajt, në mbledhjen e mbajtur më 10.1.2013, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRA, VENDBANIMET DHE ZONAT URBANE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë Rregullore më afërsisht përcaktohen kriteret dhe mekanizmat e bashkëpunimit të komunës së Ferizajt, në tekstin e mëtejme komuna, me fshatrat, vendbanimet dhe zonat urbane në ofrimin e shërbimeve publike, ndërtimin e infrastrukturës, mbrojtjen, rregullimin dhe mirëmbajtjen e ambientit dhe plotësimin e nevojave kulturore, sportive e rekreative.

Neni 2

Komuna, në kuadër të kompetencave dhe fushë veprimtarisë të nivelit lokal, mbështet krijimin e kushteve më të volitshme të mjedisit jetësor dhe sipas mundësive buxhetore në mënyrë të mëvetësishme financoon dhe bashkë financoon me komunitete lokale dhe donatorë realizimin e projekteve të ndryshme në interes të gjithë qytetarëve.

II. ORGANIZIMI TERRITORIAL DHE SHTRIRJA E LOKALITETEVE

Neni 3

Në funksion të krijimit të kushteve dhe mekanizmave për ushtrimin e kompetencave në mënyrë më të drejtpërdrejtë, territori i komunës organizohet në :

fshatra dhe zona urbane

Territori i Komunës së Ferizajt (përbëhet nga) ka gjithsej, 45(dyzet e pesë) fshatra dhe 8 (tetë) zona-urbane, Ferizaj është qendër komunale.

Me qëllim që qytetarët të kenë mundësinë e realizimit të të drejtave dhe interesave të tyre në të gjitha fushat e jetës, parashihet definim gjeografik i zonave urbane dhe lokaliteteve si vijon:

Territori i Komunës së Ferizajt është i përcaktuar me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave, si dhe me nenin 8 të Statutit të Komunës 01 nr.33.të datës 26.11.2008, përfshinë këto vendbanime:

Fshatrat: 1.Bablak; 2.Babush; 3.Balaj; 4.Bibaj; 5.Burnik; 6.Cërnillë; 7.Doganaj; 8.Dremjak; 9.Dardani; 10.Dubravë; 11.Gaçkë; 12.Gurëz; 13.Greme; 14. Jezerc; 15.Komogllavë; 16.Koshare;

17.Kosinë; 18.Lloshkobare; 19.Nikadin; 20.Neredime e Eperme; 21.Neredime e Poshtme; 22.Mirash; 23.Muhoc; 24.Manastirc; 25.Mirosalë; 26.Papaz; 27.Pleshinë; 28.Pojatë; 29.Prelez i Jerlive; 30.Prelez i Muhaxherëve; 31.Rahavicë; 32.Rakaj; 33.Sazli; 34.Slivovë; 35.Softaj; 36.Sojevë; 37.Surqinë; 38.Fshati i Vjetër; 39.Talinoc i Jerlive; 40.Talinoc i Muhaxherëve; 41.Tërn; 42.Varosh; 43.Zllatar dhe 44. Zaskok.

Qyteti i Ferizajt

1). Ferizaj, Zona-Urbane nr.1 Qendra e cila kufizohet me rr"Limani Reka", "Fehmi Agani", "At Nikë Prela" në jug; rrugët "Tiranës", "Gëzim Sahiti", "Enver Hadri", "Mic Sokoli", "Xheve Lladrovci", "Cen Dugolli" në lindje; rrugët "Driton Islami", rrugicën afër "Nera Impeksit" neveri; dhe jazi afër shkollës normale rrugët "Uran Tinova", Hoxhë Kadri Prishtina", Ahmet Hoxha", "Imri Halili në perëndim.

2). Ferizaj, Zona-Urbane nr.2 Kjo zonë kufizohet me rr"Vëllezërit Gervalla" në jug; Rrugët Mic Sokoli", "Xheve Lladrovci", Cen Dugolli" në perëndim Rrugën "Driton Islami" në veri; Dhe kufiri i zonës urbane sipas PZHU në lindje. Të bëhet perkufizimi i saktë i pjesës së qytetit .

3). Ferizaj, Zona –Urbane 3 Kjo zonë kufizohet me rr "Driton Islami" në jug me magjistralen Prishtinë-Shkup në lindje, me kufirin e zonës urbane sipas PZHU në veri dhe rrugën Ferizaj- Shtime në perëndim.

4). Ferizaj, Zona –Urbane 4. Kjo zonë kufizohet me rrugën "Epopeja e Jezercit", "Ismet Ramadani" në jug; me rr "Uran Tinova" rrugicën afër "Nera Impeksit", rr"Ferizaj Shtime në lindje, me jazin afër shkollës normale në veri dhe kufirin e zonës urbane sipas PZHU në perëndim.

5). Ferizaj, Zona Urbane 5. Kjo zonë kufizohet me kufirin e zonës urbane sipas PZHU në jug; me rr. "Enver Topalli" në lindje; me rr. "Hoxhë Kadri Prishtina", "Ahmet Hoxha" në veri dhe kufirin e zonës urbane sipas PZHU në perëndim.

Ferizaj, Zona Urbane 6. Kjo zonë kufizohet me kufirin e zonës urbane sipas PZHU në jug; hekurudhën Ferizaj Hani i Elezit në lindje; me rr."Ahmet Hoxha" dhe "Limani Reka" në veri dhe me rr."Enver Topalli" në perëndim.

Ferizaj, Zona Urbane 7. Kjo zonë kufizohet me rr"Fehmi Agani", "Nikë Prela" dhe rr."Rexhep Bislimi" në veri; Kufirin e zonës urbane sipas PZHU në jug-lindje; dhe

Me hekurudhën Ferizaj-Hani i Elezit në jug-perëndim

Ferizaj, Zona Urbane 8. Kjo zonë kufizohet me rr"Rexhep Bislimi" në jug; rrugët "Tiranës", "Gëzim Sahiti", "Enver Hadri", në perëndim; rrugët "Vllezrit Gervalla", rrugën Ferizaj-Rahovicë, në veri dhe kufiri i zonës urbane sipas PZHU në lindje.

Neni 4

4.1 Kuvendi i Komunës, pas konstituimit mbi bazën e zgjedhjeve lokale, në afatin prej 30 ditësh, e përcakton strukturën e Këshillit të fshatrave dhe lagjeve urbane apo komitetit të fshatit dhe zonave-urbane.

4.2 Mandati, kohëzgjatja e ushtrimit të detyrës së kryetarit të fshatit, zonës-urbane, është drejtpërdrejt i lidhur dhe zgjatë sipas mandatit (afatit)-zgjedhor komunal.

Kryetari dhe Kryesia e Fshatit përkatësisht Zonës-urbane

Neni 5

5.1 Në mbështetje të punës së Kuvendit të Komunës, Kryetarit të Komunës si dhe Administratës Publike, si përfaqësues i komunitetit duhet të zgjidhet, kryetari i fshatit, zonës-urbane, me rolin për plotësim të detyrave të përcaktuara nga organet kompetente të qeverisjes vendore, mbi bazën e partneritetit të këtyre me komunitetin, në hartimin e prioritetëve, zbatimin e ligjit, rritjen e shkallës së njohjes së terrenit nga Administrata Komunale si dhe organizimin dhe mobilizimin e komunitetit për çështje të caktuara.

5.2 Mënyra dhe lartësia e kompensimit për kryetarët e fshatrave përkatësisht të zonave-urbane vendoset nga Kuvendi i Komunës, me vendim të veçantë.

5.3 Kryetari i fshatit, përkatësisht zonës-urbane, zgjidhet për secilin fshat dhe zonë urbane.

5.4 Në afat prej 30 ditësh, pas zgjedhjes së kryetarit të fshatit, zonës-urbane, i njëjti në koordinim me organet komunale do të organizojë tubimin e qytetarëve të këtij komuniteti dhe me vota të hapura do ta zgjedhin kryesinë e fshatit, zonës-urbane. Kryesia e fshatit, zonës-urbane do të jetë trup konsultativ i kryetarit të fshatit, zonës-urbane, për nevojat dhe prioritetet e komunitetit. Anëtarët e kryesisë së fshatit, zonës-urbane, nuk do të kompensohen për punën e tyre, pasi që puna e tyre mbështetet në gatishmërinë e anëtarëve për punë dhe kontribut vullnetar, për nevojat dhe interesat e komunitetit.

5.5 Kryesia e fshatit, zonës-urbane duhet të përbëhet nga përfaqësimi i drejtë gjinor, i minoriteteve dhe i lagjeve në fshatra. Kryesia do të ketë së paku (5) anëtar.

II PROCEDURA PËR ZGJEDHJE DHE SHKARKIM TË KRYETARIT

Procedura për zgjedhjen e Kryetarit të Fshatit, Zonës Urbane

Neni 6

6.1 Zgjedhja e kryetarit të fshatit, përkatësisht të zonës-urbane, bëhet me kalimin e procedurave demokratike të zgjedhjes, si vijon

6.2 Kryetari i tanishëm i fshatit, përkatësisht zonës-urbane, fton në mbledhje përfaqësuesit e Subjekteve Politike të fshatit përkatësisht zonës-urbane, me të cilët formon Këshillin Nismëtar për organizimin dhe procedimin e mbledhjes për zgjedhjen e kryetarit të ri.

6.2.1 Në fshatraf dhe zonat urbane në të cilat nuk ka kryetar të fshatit apo zonës urbane, kryetari i komunës do të themelojë këshillin nismëtar për organizimin dhe procedimin e mbledhjes për zgjedhjen e kryetarit të ri.

Këshillit Nismëtar për të organizuar mbledhjen zgjedhore të fshatit përkatësisht zonës-urbane.

6.3 Komuniteti nëpërmjet votimit të fshehtë e zgjedh kryetarin e fshatit përkatësisht zonës-urbane.

6.4 Këshilli Nismëtar i propozon tubimit 3 (tre) anëtarë të Komisionit për Organizimin e Procesit të Votimit, si dhe 5 (pesë) anëtarë të Komisionit për Numërimin dhe Shpalljen e Votave, të cilat miratohen me vota të hapura.

6.5 Kryetar zgjidhet kandidati, i cili ka fituar shumicën e thjeshtë të votave të banorëve të pranishëm në mbledhjen e organizuar për zgjedhjen e kryetarit.

6.6 Të drejtën për të votuar e kanë personat prezent në mbledhje që kanë mbushur moshën 18 vjeçare në përputhje me Ligjin për Zgjedhjet.

6.7 Pas zgjedhjes së kryetarëve të fshatrave dhe zonave urbane lista dërgohet të kryetari i komunës dhe e cila listë verifikohet nga Kuvendi i Komunës.

Procedura për shkarkimin e Kryetarit të Fshatit, Zonës-urbane

Neni 7

Kryetari i fshatit, zonës-urbane, lirohet dhe shkarkohet nga detyra, sipas procedurës e cila zhvillohet për nominimin dhe zgjedhjen e tij, në pajtim me nenin 6 të kësaj Rregullore.

III BASHKËPUNIMI ME ORGANET KOMUNALE

Neni 8

8.1 Marrëdhëniet e kryetarit të fshatit përkatësisht zonës-urbane, me organet komunale janë marrëdhënie bashkëpunimi dhe partneriteti në plotësim të detyrave të caktuara nga organet e qeverisjes lokale dhe vendore. Ato informojnë reciprokisht njëri-tjetrin për problemet që lidhen me plotësimin e detyrave, me karakter publik.

8.2 Konfliktet dhe mosmarrëveshjet, që mund të lindin në mes në mes kryetarit të fshatit, zonës urbane dhe kryesisë, trajtohen nga zgjedhësit e tyre.

IV DETYRAT DHE PËRGJEGJËSIT

Detyrat dhe obligimet e Kryetarit të Fshatit, Zonës-urbane

Neni 9

Detyrat dhe obligimet e Kryetarit të fshatit, zonës-urbane, përcaktohen me këtë rregullore si në vazhdim: Përbërja e Këshillit caktohet sipas strukturës së miratuar në Kuvend të Komunës dhe propozimeve të subjekteve përkatëse politike.

9.1 Kryetari i fshatit, zonës-urbane është personalitet unifikues që përfaqëson fshatin, zonën-urbane në instancat e institucioneve publike.

9.2 Zhvillon takime në mënyrë të organizuar me banorët e fshatit, përkatësisht zonës-urbane për marrjen e mendimeve si dhe shqetësimet e tyre për probleme me karakter publik.

9.3 Kryetari i paraqet institucionit kompetent përfshirjen e propozimeve për projektet prioritare nga fshati, zona-urbane fillimisht për t'u inkorporuar në planin zhvillimor dhe strategjik të komunës dhe pastaj për aprovim si prioritet në buxhet.

9.4 Njofton drejtoritë e komunës kur i kërkohet ose për konstatime të verifikuara drejtpërdrejt nga ana e tij, në rastet e emergjencave civile për zjarre, përmbytje, shembje dherash, tërmete etj.

V OBJEKTET DHE ELEMENTET E MARRËVESHJES

Neni 10

Objekt i bashkëpunimit të komunës me fshatrat, zonat-urbane janë të gjitha çështjet në kompetencë të komunës, ku përveç tjerash përfshihen:

- a) Planifikimi urban dhe rural;
- b) Furnizimi me ujë të pijes, ndërtimi i kanalizimit të ujërave të zeza, kanalizimit atmosferik, dhe sistemit për ujitje;
- c) Mbrojtja shëndetësore parësore;
- d) Zhvillimi i turizmit;
- e) Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike dhe varrezave;
- f) Aktivitetet kulturore, sportive dhe rekreative.

VI SHKARKIMI, E DREJTA PËR T'U EMËRUAR DHE DORËHEQJA

Shkarkimi nga pozita e Kryetarit të fshatit, zonës-urbane

Neni 11

Kryetari i fshatit, zonës-urbane do të shkarkohet nga pozita, nëse i njëjti:

11.1 Është dënuar me burgim mbi gjashtë (6) muaj ose me çfarëdo dënimi, për veprat penale të kryera nga motivet e ulëta, e të cilat e bëjnë të pa denjë për ushtrimin e detyrës së kryetarit të fshatit, zonës-urbane (vepra penale e korrupsionit, vjedhjes, mashtrimit, kundër moralit etj).

11.2 Është gjetur se vuan nga shëndeti mendor apo për shkak të paaftësisë mendore,

11.3 Nuk është i aftë të menaxhojë punët nga kompetenca e tij.

11.4 Në qoftë se, në çdo kohë pas zgjedhjeve, pushon të jetë banor i fshatit, zonës-urbane.

DORËHEQJA NGA KANDIDATURA DHE NGA POZITA E KRYETARIT TË FSHATIT PÛRKATËSISHT ZONËS-URBANE

Neni 12

Dorëheqja e kandidatit nga Kandidatura dhe nga pozita e kryetarit të fshatit, zonës-urbane mund të bëhet në çdo kohë. Dorëheqja duhet të jetë e paraqitur me shkrim dhe të jetë e nënshkruar nga vet personi i cili e paraqet dorëheqjen.

VII E DREJTA PÛR T'U EMËRUAR SI KANDIDAT PÛR KRYETAR TË FSHATIT, ZONËS-URBANE

E drejta për t'u emëruar si kandidat për kryetar të fshatit, zonës-urbane, përkufizohet në kushtet e përgjithshme si vijon:

Neni 13

13.1 Të jetë banor i përhershëm i fshatit, zonës-urbane për të cilin emërohet;

13.2 Të ketë qenë banor i fshatit, zonës-urbane 3 vjet para emërimit;

13.3 Të ketë mbushur moshën 21 vjeçare;

13.4 Të mos ketë qenë i shkarkuar nga pozita e Kryetarit, për shkaqet e parapara në nenin 11, pika. 1, e kësaj rregulloreje;

13.5 Të mos jetë anëtarë në Kuvendin e Komunës, përkatësisht të mos ketë post publik;

13.6 Të gëzon autoritet dhe respekt te banorët e fshatit, lagjes-urbane.

VIII TRANSPARENCA

Neni 14

Puna dhe aktivitetet sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje janë plotësisht transparente dhe përveç mjeteve të informim publikohen në mënyrë të rregullt në Web-faqen zyrtare të komunës dhe tabelën e shpalljeve.

IX DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15

Zbatimin e Rregullores e bënë Kryetari i Komunës.

Neni 16

Në rast konflikti të dispozitave të kësaj Rregulloreje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës, zbatohen dispozitat e Ligjit dhe Statutit .

Neni 17

Ndryshimet dhe plotësimet eventuale në këtë rregullore, do të bëhen sipas procedurës së nxjerrjes së saj.

Neni 18

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen vendimet dhe rregulloret e më pazëshme për organizimin, strukturën dhe funksionimin e kryetarëve të fshatrave dhe lagjeve-urbane në territorin e Komunës së Ferizajt.

Neni 19

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës në Ferizaj.

Nr. 01 67
Ferizaj Datë:



Kryesuesi i Kuvendit